



Arrestohet i dyshuari që shtiu me armë në ajër për ta frikësuar mikun



16/01/2023 22:42



Policia e Kosovës në rajonin e Gjilanit ka njoftuar se ka arrestuar një të dyshuar për përdorim të armës dhe armëmbajtje pa leje.

Sipas Policisë i dyshuari është arrestuar të hënë, për një rast që dyshohet se ka ndodhur me 6 janar.

Në njoftimin e Policisë së Kosovës thuhet se i arrestuari dyshohet se me qëllim të frikësimit të mikut të tij, kishte shtënë në ajër me armë zjarri.

‘Drejtoria Rajonale e Policisë Gjilan, Stacioni Policor Gjilan me datën 06.01.2023 kishte pranuar informatë për një rast të dhunës në familje në një fshat të Gjilanit. Në atë rast i dyshuari V.B. (1970) dyshohet se me qëllim frikësimi ndaj viktimës, mikut të tij kishte shtënë në ajër me armë zjarri.

Patrulla Policore kishte dalë në vendin e ngjarjes por nuk kishte arritur që të takonte të dyshuarin me ç’ rast e kishte vënë në kërkim policor.

Sot me datën 16.01.2023 falë një pune mirë të organizuar operative nga ana e Hetuesve Policor është arritur që të takohet i dyshuari i lartcekur nga i cili edhe është konfiskuar një (1) pushkë gjuetie si dëshmi për Gjykatën.

I dyshuar pas arrestimit është intervistuar në prani të avokatit mbrojtës.

Në lidhje me rastin është njoftuar Prokurori i Shtetit i cili ka urdhëruar që ndaj të dyshuarit të ngritët kallëzim penal për veprat penale „Përdorim i armës”, „Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” dhe „Shkaktim i rezikut të përgjithshëm” dhe rasti do të procedohet në Prokurorinë Themelore”, thuhet në njoftimin e policisë.

Artikuj të ngjashëm



January 17, 2023

Gucati e Haradinaj në Hagë, aktgjykimi i apelit shpallet më 2 shkurt



January 17, 2023

Ish-mytii: Ka persona VIP që kanë shpenzuar 200 mijë euro për një varr



January 17, 2023

Burri bëhet për spital nga gruaja në Prishtinë



January 17, 2023

Këshilli Prokurorial: Haxhiu vazhdon me deklarata të pavërteta për sistemin prokurorial...



January 17, 2023

Krasniqi: Kurti ia ndaloi fjalën ish-luftëtarit të UÇK-së vetëm pse do...



January 17, 2023

“Lavdet” për Ivanoviqin, Deliu i reagon Kurtit: Nuk e di a...

LAJME TË FUNDIT



Gucati e Haradinaj në Hagë, aktgjykimi i apelit shpallet më 2 shkurt



Burri bëhet për spital nga gruaja në Prishtinë



Publikohet video/ Momenti kur Kejvina godet Luizin shuplakë gjatë spektaklit



Krasniqi: Kurti ia ndaloi fjalën ish-luftëtarit të UÇK-së...